



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 33, datë 29.06.2021

“PËR MIRATIMIN E FUSHATËS SË PARTNERITETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË ME QYTETARËT”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e radhës mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Kryesia e Këshillit Bashkiak, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 16, pika 1, neni 18, neni 19 dhe neni 54, pika k, ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Rregullores së Këshillit “Për marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat” (Konsultimeve Publike)

VENDOSI:

1. Të miratojë zhvillimin e aktivitetit **“Fushata e Partneritetit të Këshillit me Qytetarin”**.
2. Aktiviteti do të zhvillohet sipas programit të detajuar bashkangjitur këtij vendimi.
3. Për realizimin e aktivitetit të kryhen shpenzime nga buxheti I Këshillit të Bashkisë për vitin 2021.
4. Për këtë vendim ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari i Këshillit, Sekretariati dhe komisionet e Këshillit Bashkiak të mbështetura nga specialistët e administratës së Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 9 vota pro , vota kundër - s’ka , vota abstenim - s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

